

BASHKIA E TIRANËS
REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.2, SH.A
NJËSIA E PROKURIMIT

PROCES - VERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje lëndë djegëse Pelet për kaldajat”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Lëndë druri 03419000-0,

VLERA E FONDIT LIMIT:

5,241,600 (pesë milion e dyqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Rezidenca Studentore Universitare Nr.2 Sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3; ne masen 2% te e vlerës së përlllogaritur të kontratës ne nje nga format e parashikuara ne ligjin nr.162/2020 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” konform nenit 83, perkatesisht ne vleren prej 104,832 lekë pa tvsh.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, Sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 (të vlefshme) ose ekuivalentetë tij të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.

2.1.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 14001:2015 (të vlefshme) ose ekuivalentetë tij të Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.

Argumentim: Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë", është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së shërbimit që ofron.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikatën ISO 14001:2015, ose ekuivalente me të "Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit", lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të mjedisit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për vitet 2020,2021,2022 e cila duhet të ketë një vlerë jo më pak se 40% të fondit limit që prokurohet

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43 si dhe nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

5,241,600 x 0.4= 2.085.840 (dy milion e tetëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzet) lekë pa tvsh.

Kërkohej vlera jo më pak se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, bazuar në pikë 4, të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi, kjo është një procedurë e Hapur e Thjeshtuar dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 "Mbi Rregullat e Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi tëArdhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore të vitit 2020,2021,2022 që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhirore vjetore është bërë bazuar në legjislacionin tatimor ku xhiroja dhe bilancet kanë si afat përfundimtar për tu mbyllur dhe dorëzuar pranë organeve tatimore maksimumi deri në fund të muajit Prill të vitit që vjen. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar sipas ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **5,241,600 x 0.2 = 1.048.320 (një milion e dyzet e tetë mijë e treqind e njëzet) lekë pa tvsh.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

5,241,600 x 0.2 = 1.048.320 (një milion e dyzet e tetë mijë e treqind e njëzet) lekë pa tvsh.

2.3.2. Me qëllim vërtetimit të pajtueshmërisë së mallit për të cilin do të ofertohej me specifikimet teknike të kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është vetë prodhuesi i mallrave ai duhet të paraqesë: Autorizim të prodhuesit ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për mallin objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, email, website, kjo e nevojshme për A.K në rast verifikimi nga ana e tij.
2. Dëshmi të testimeve zyrtare të kryera të lëshuara nga institucione /laboratorë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë, ose nga një Organizëm Ndërkombëtar Akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë, që vërtetojnë pajtueshmëri të pajtueshmërinë e mallit të prodhuar me specifikimet teknike të kërkuara. Dëshmia me të dhënat e testimeve zyrtare të kryera duhet të jetë lëshuar jo më parë se viti 2023

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/a**, dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) **përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;**... c) **aftësinë teknike dhe profesionale;**...

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Njësia e prokurimit bazuar në natyrën e mallit objekt prokurimi që kërkohet të furnizohet, *duke qënë se ky mall objekt prokurimi ka rëndësi në lidhje me materialin nga i cili përbëhet/prodhohet (vlera kalorike) dhe duhet të jetë prodhuar sipas standartit të kërkuar, pra, duhet të jenë i një cilësie të mirë*, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar, që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do ta sigurojnë këtë mall/produkt objekt prokurimi, katalogun/ fragmente të katalogut me të dhënat teknike, si dhe dëshmitë e testimeve zyrtare të kryera, me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse malli/ produkti i prodhuar për të cilën do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës është në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriterin për kapacitetin profesional e teknik si më lart duke qënë se ky kriter është i detyrueshëm, është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi te gjitha i shërben autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.3. Operatori të ketë në dispozicion 1(një) automjet për transportin e lëndës djegëse pelet e vërtetuar me akt shit blerje ose kontratë qeraje. Për të vërtetuar këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe dokumentacion e mjetit për transport gazoili si më poshtë:

Leje qarkullimi

Akt kolaudimi mbi kontrollin teknik te mjetit

Polisë sigurimi

Taksat vjetore

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues të kërkuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Për efekt të verifikimit të gjendjes gjyqësore Operatorët Ekonomik së bashku me dokumentacionin e kërkuar, duhet të sjellin edhe fotokopjen e çertifikatës personale të administratorit ose të ortakëve të shoqërisë (nëse është rasti).

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e certifikatës personale të administratorit të shoqërisë ose të ortakëve të shoqërisë (nëse është rasti).

Argumentimi: Ky kriter është bazuar në Njoftimin e përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 1155prot., datë 01.02.2019 dhe Ministrisë së Drejtësisë nr.1001/1 prot., datë 01.02.2019).

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR PELET

Nr	Treguesit	Njësia	Parametrat
1	Densiteti	Kg/m ³	600-750
2	Fuqia kalorifike	kWh/kg	> 5
3	Mbetja pas djegjes(hirit)	%	≤ 1
4	Permbajtja e squfurit	%	< 0.1
5	Amballazhimi	thase	15kg

6	Lageshtia	%	≤10
7	Dimensione (diametri)	mm	6-8
8	Dimensione(gjatesia)	mm	20-40

Peleti të jetë i prodhuar nga druri.

GRAFIKU I LËVRIMIT

<i>Nr.</i>	<i>Emëtimi</i>	<i>Sasia / kg</i>
1	Pelet	149760 (njëqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë)

Sipas tabelës më poshtë është e detajuar grafiku mujor i lëvrimit për peletin

Muaji	Kërkesa mujore kg
Janar	18720
Shkurt	18720
Mars	14040
Prill	14040
Maj	14040
Qershor	9360
Korrik	9360
Gusht	0
Shtator	0
Tetor	14040
Nëntor	18720
Dhjetor	18720
TOTALI	149760

I. Argumentimi i përlllogaritjes së vlerës së fondit limit:

Lidhur me përlllogaritjen e fondit limit total në dispozicion, AK argumenton se, ky fond përbëhet nga buxheti i shoqërisë për vitin 2024. Për përlllogaritjen e fondit limit AK i është referuar çmimeve të tregut. Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është ngritur grupi i punës për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, neni 76.

Gjithashtu, sipas analizës së grupit të punës, bazuar në normativën e shpenzimit të peletit dhe praktikës së harxhimit të tij në vitin e fundit ushtrimor, ka rezultuar si sasi e nevojshme objekt prokurimi (sipas të dhënave në DST).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike.

Grupi i punës hartoi specifikimet teknike të peletit bazuar llojit të kaldajave të instaluara

Sqarime; Certifikatat dhe deklaratat e kerkuara me siper jane te domosdoshme per ti dhene garancite e nevojshme autoritetit kontraktor lidhur me kapacitet teknike dhe ligjore qe operatori ekonomik ka per te realizuar objektin e prokurimit.